



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRI

Nr. 17773 Prot.

Tiranë, më. 04.12.2023

URDHËR

Nr. 186, datë 04.12.2023

“Për miratimin e “Formularit të Vetë deklarimit “Mbi përdorimin e aplikacioneve SKY ECC dhe ENCROCHAT””

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të gurmës “e”, pikës 2, të nenit 12 të Ligjit nr.128/2021 për “Agjencisë për Mbikëqyrjen Policore”, me qëllim miratimin e formularit të vetëdeklarimit;

URDHËROJ:

1. Miratimin e formularit të vetëdeklarimit “Mbi përdorimin e aplikacioneve SKY ECC dhe ENCROCHAT”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Plotësimin e Formularit të Vetëdeklarimit nga punonjësit e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, 30 diteve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
3. Strukturat e personelit të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore të bëjnë shpërndarjen dhe grumbullimin e formularëve të plotësuar.
4. Me zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
5. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BRENDSHËM

Taulant BALLA

